



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO		AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT	
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE		ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep.	2-D/DPK	Nr Prot	01-1015/15
Dep.		Br Prot	Prot No
Nr. I faq.		Data	03.04.2015
Broj stranica	02	Datum	
Nr. pages			
PRISTINE			

DATE/A:	03/04/2015
REFERENC-Ë:	DPK-DPKPP 03-03/787/15
PËR/ZA/TO:	z. Gazmend RUSHITI Drejtore i Prokurimit në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës
CC:	z. Curr GJOCAJ Drejtore i Përgjithshëm në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës
NGA/OD/FROM:	Hasan PRETENI Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull: "Furnizim me material higjienik"

I nderuar z. RUSHITI,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, lidhur me "Furnizim me material higjienik" me numër prokurimi 701/15/033/121, Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

O P I N I O N

Me të cilin kërkohet nga ju si Autoritet Kontraktues që t'i ndërmerrni të gjitha veprimet e nevojshme për evitimin e shkeljeve të evidentuara në lidhje me Tenderin me titull "Furnizim me material higjienik" me numër prokurimi 701/15/033/121, në mënyrë që të respektohen dispozitat përkatëse të Ligjit nr. 04-L/042 për Prokurimin Publik.

A r s y e t i m

Zyra e Prokurimit pranë Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës ka iniciuar Procedurën e Prokurimit me titull: "Furnizim me material higjienik" me numër prokurimi 701/15/033/121, e cila është publikuar në faqen elektronike të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik më datë 06/03/2015. Autoriteti Kontraktues për këtë aktivitet të prokurimit ka paraparë Procedurën e hapur, kontratë kornizë me vlerë të mesme për furnizim me 24 artikuj higjienik për nevojat e Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Agjencia Kundër Korrupsion, përmes Divizionit për Parandalimin e Korrupsionit në Prokurimin Publik ka identifikuar këtë aktivitet të prokurimit si lëndë për trajtim. Gjatë shqyrtimit të dokumentacionit në dispozicion për këtë procedurë të prokurimit në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit, Agjencia Kundër Korrupsion ka hasur në disa kërkesa që janë në kundërshtim me ligjin në fuqi për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës.

Në Dosjen e Tenderit, ANEKSI 1 SPECIFIKIMET TEKNIKE TË DETYRUESHME, në tabelën e artikujve të kërkuar, në pikën 12,13,14,21,24 gjegjësisht për produktet: **Domestos, Vim, Varikin**, Detergjent për makinën e larjes së petkave 1/9 **Merix** dhe **Vanish** janë kërkuar emrat e produkteve. Autoriteti kontraktues nuk do të krijojë ose imponojë dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të parandaluar krijimin ose imponimin e rrethanave ose kushteve që rezultojnë në diskriminim territorial, fizik, material, personal ose organizativ për prodhuesit ose operatorët ekonomik. Me caktimin e emërimit të prodhuesit për produktet (materialet) e kërkuara në Dosjen e Tenderit, Autoriteti Kontraktues ka favorizuar prodhuesin e caktuar, duke i diskriminuar të tjerët në raport me favorizuesin.

Veprimet e Autoritetit Kontraktues konsiderojmë se bien ndesh me nenin 7 Barazia në trajtim dhe jo Diskriminimi si dhe Nenin 27 Dosja e Tenderit të Ligjit për Prokurimin Publik Nr.04/L-042

Konsiderojmë se shkelje të tilla nuk duhet lejuar në procedura të prokurimit, andaj Agjencia Kundër Korrupsion rekomandon anulimin e kësaj Procedure të Prokurimit dhe kërkon nga Autoriteti Kontraktues që t'i shmang dhe të mos i përsëris praktikat e tilla në të ardhmen.

Autoritetet Kontraktuese e informojnë Agjencinë për veprimet e ndërmarra.

Me respekt !